



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË "HEKURUDHAT E KOSOVËS - INFRAKOS", SH. A. PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga  
Vlora Spanca,  
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të "Hekurudhat e Kosovës - Infracos", sh. a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të "Hekurudhat e Kosovës - Infracos", sh. a. (Infracos, Sh. A.), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të "Hekurudhat e Kosovës - Infracos", sh. a. deri me 31 dhjetor 2023, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2023, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**Baza për Opinion të Kualifikuar**

- B1 Ndërmarrja Infrakos sh.a kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar shumën 15,226,015€, si rezervë të rivlerësimit (tepricë). Megjithatë, për këtë vlerë të prezantuar, nuk ka arritur të na sigurojë të dhënat kontabël apo dëshmi për të vërtetuar shumën e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo çështje nuk ishte korrigjuar që nga viti 2011.
- A1 Ndërmarrja në pasqyrën e pozicionit financiar kishte prezantuar detyrimet ndaj granteve në vlerë 40,080,848€. Megjithatë, ne kemi identifikuar se vlera prej 4,750,000€ e detyrimeve ndaj granteve nuk ishte e mbështetur në dëshmi mbështetëse si raport pranimi, apo ndonjë dëshmi tjetër relevante.
- B2 Ndërmarrja që nga viti 2007 e këndeje nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive të ndërmarrjes. Ne kemi analizuar regjistrin e pasurisë dhe kemi identifikuar se në këtë regjistër janë të përfshira 1,686 pasuri me kosto historike prej 7,573,844€, të cilat janë zhvlerësuar në tërësi dhe vlera neto e tyre në librat kontabël është zero (0).

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera të Infrakos, Sh. A. kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë të përshkruara më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodit të Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të "Hekurudhat e Kosovës - Infracos", sh. a..

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i "Hekurudhat e Kosovës - Infracos", sh. a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të "Hekurudhat e Kosovës - Infracos", sh. a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>2</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të "Hekurudhat e Kosovës - Infracos", Sh. A. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos", sh. a..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos", sh. a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Gjetjet që kanë ndikuar në opinionin e auditimit janë mungesa e dëshmive për rezervën e rivlerësimit, mos vlerësimi i pasurive dhe mungesa e dëshmive burimore për grantet.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar në sektorin publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 4 rekomandime, prej tyre 1 është rekomandim i ri, 3 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Mungesa e të dhënave kontabël për rezervën e rivlerësimit

##### Gjetja

SNK 16 përkatësisht pika 39 përcakton se: Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja kreditohet drejtpërdrejt tek kapitalet e veta me titullin mbivlerë (tepricë) rivlerësimi. Po ashtu SNK 16 përcakton se: një aktive afatgjate njihet si aktive nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen rrjedhin të njëjta ekonomike dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Ndërmarrja kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar shumën 15,226,015€, si rezervë të rivlerësimit (tepricë). Megjithatë, për këtë vlerë të prezantuar, nuk ka arritur të na sigurojë të dhënat kontabël apo dëshmi për të vërtetuar shumën e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo çështje nuk ishte korrigjuar që nga viti 2011. Infrakos në planin e veprimit kishte potencuar se këtë çështje nuk mund të adresojnë për shkak të mungesës së informatave burimore dhe kjo mbetet të adresohet në momentin e rivlerësimit të pasurive.

Bazuar në konfirmimet zyrtare, kjo shumë është trashëguar nga ish Hekurudhat e Kosovës (Infrakos dhe Trainkos), për të cilat nuk ka dëshmi historike se e njëjta shumë është e bartur me saktësi.

##### Ndikimi

Mungesa e dëshmive apo të dhënave analitike dhe mos regjistrimi i të dhënave kontabël në sistem e kontabilitet pamundëson verifikimin e rezervës së rivlerësimit si dhe vë në dyshim vërtetësinë e informatave financiare.



**Rekomandimi B1** Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr veprime të menjëhershme në sigurimin e informatave lidhur me tepricën e rivlerësimit si dhe sigurojë se pasqyrat financiare vjetore të përgatiten duke u bazuar në të dhënat e konfirmuara kontabël dhe me dëshmitë e duhura.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A1 - Mungesë e të dhënave të plota për grantet**

**Gjetja** SNK 20, përcakton se Grantet qeveritare që lidhen me pasuritë, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiare ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë - detyrime ndaj grantit ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e pasurisë.

Ndërmarrja në pasqyrën e pozicionit financiar kishte prezantuar detyrimet ndaj granteve në vlerë 40,080,848€. Megjithatë, ne kemi identifikuar se vlera prej 4,750,000€ e detyrimeve ndaj granteve nuk ishte e mbështetur në dëshmi mbështetëse si raport pranimi, apo ndonjë dëshmi tjetër relevante.

Mungesa e dëshmive burimore ndërlidhët me studimin e fizibilitetit për projektin e "Linjës së 10 hekurudhore" dhe të cilat i referohen viteve të mëhershme.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të brendshëm për të siguruar në kohë dokumentacionin e nevojshëm dhe departamenti i financave ishte bazuar vetëm në një korrespondencë (email) nga njësia për implementim të projekteve në ndërmarrje lidhur me shërbimet e pranuar.

**Ndikimi** Prezantimi i granteve pa pasur dëshmi mbështetëse, mund të ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e granteve dhe investimeve në vijim.

**Rekomandimi A1** Bordi i Drejtorëve, duhet të sigurojë dëshmi relevante me rastin e regjistrimit të detyrimeve ndaj granteve me qëllim që prezantimi në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Mos rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes**

**Gjetja** Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 16, pasuritë afatgjata materiale përcakton se: rivlerësimet duhet të bëhen në mënyrë të rregullt çdo tre deri pesë vjet, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e pasurisë nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Ndërmarrja që nga viti 2007 e këndeje nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive të ndërmarrjes. Ne kemi analizuar regjistrin e pasurisë dhe kemi identifikuar se në këtë regjistër janë të përfshira 1,686 pasuri me kosto historike në shumën prej 7,573,844€, të cilat janë zhvlerësuar në tërësi dhe vlera neto e tyre në librat kontabël është zero (0).

Ne kemi vërejtur se regjistri i pasurive përmban 369 pasuri të cilat kishin koston historike 7.3 mil/euro dhe 1,317 pasuri tjera të cilat kishin koston historike 238 mijë/euro.

Fakti që pasuritë e ndërmarrjes si objektet, makineritë, ndërtesat e stacioneve hekurudhore, trafo stacionet e tjera janë në përdorim (aktive) dhe vlera neto në libra është zero konsiderojmë që duhet të bërë rivlerësimi dhe rishikimi i jetëgjatësisë së tyre.

Bazuar në konfirmimet e zyrtarëve, mungesa e rivlerësimit të pasurive kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja në vazhdimësi ishte ballafaquar me mungesën e mjeteve financiare, dhe nuk kishte mundësi të kryej procesin e rivlerësimit.

**Ndikimi**

Mos kryerja e rivlerësimit të pasurive të cilat ende janë në përdorim, rritë rrezikun që vlera kontabël e tyre e prezantuar në pasqyra financiare, të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e drejtë.

**Rekomandimi B2**

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrin të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime për rivlerësimin e pasurive nga një vlerësues i licencuar. Në mungesë të mjeteve vetanake duhet shihet mundësia e sigurimit të mjeteve nga aksionari.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Kontrollet e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

#### Çështja B3 - Mangësitë e Sistemit Informativ të Kontabilitetit

##### Gjetja

Ligji nr. 06/L-032, Neni 11, Regjistrat kontabël përfshijnë regjistra të hyrjeve fillestare kontabël dhe regjistra mbështetës, siç janë kontrollet dhe regjistrat e transfereve të fondeve elektronike; faturave; kontratave; librave kryesor dhe ato dytësor, shënimeve në ditar dhe rregullimeve tjera në pasqyrat financiare të cilat nuk janë reflektuar tek hyrjet në ditar, dhe regjistrat si fletë pune që mbështesin alokimet e kostos, llogaritjet, barazimet dhe shpalosjet. Regjistrat kontabël ruhen në sistemin e regjistrimit të dyfishtë kontabël.

Ne kemi identifikuar se Sistemi Informativ i Kontabilitetit të cilin ndërmarrja e ka në përdorim nga viti 2003 dhe përditësimi nuk ishte bërë që nga viti 2008. Sistemi kontabilitetit nuk gjeneron raporte të përshtatshme analitike dhe të integruara të shënimeve financiare. Po ashtu, nga viti 2014 ky sistem i kontabilitetit nuk kishte mirëmbajtje.

Gjatë vitit 2023 ndërmarrja kishte zhvilluar procedurat e kontraktimit për blerjen e sistemit të kontabilitetit dhe kishte lidhur kontratë për "Furnizim me softuer për menaxhimin financave dhe asetëve". Këtë projekt e kishte planifikuar të realizojme mjetet e financuara nga Ministria e Ekonomisë. Mirëpo, kjo kontratë ishte anuluar pasi që operatori ekonomik nuk i kishte përmbushur obligimet e saj kontraktuale.

Për kundër faktit, që ndërmarrja kishte lidhur marrëveshje kontraktuale për sigurimin e softverit të kontabilitetit, kjo kontratë ishte anuluar pasi që operatori ekonomik nuk i kishte përmbushur obligimet e saj kontraktuale.

##### Ndikimi

Mos përditësimi i softuerit të kontabilitetit ka ndikuar që ky sistem i kontabilitetit nuk gjeneron raporte të përshtatshme analitike dhe të integruara të shënimeve financiare.

##### Rekomandimi B3

Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj që sistemi informativ i kontabilitetit të gjeneroj të gjitha informacionet e nevojshme duke përfshirë ditarin kryesor. Gjatë procesit të blerjes ndërmarrja duhet të përcaktoj saktë komponentët që duhet të përmbaj sistemi informativ i kontabilitetit.


#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të ndërmarrjes Infracos sh.a ka rezultuar në 16 rekomandime kryesore. Ndërmarrja kishte përgatitur/nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, 13 rekomandime janë zbatuar; dhe 3 nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 1, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë, që të gjitha financimet nga grantet dhe të tjerat të regjistrohen dhe prezantohen në pasqyrat financiare.	Ndërmarrja kishte arritur të adresoj këtë rekomandim duke i regjistruar faturat e granteve të cilat ishin të pa regjistruara.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të bërë korrigjimet adekuate në kontabilitet në mënyrë që prezantimi i të hyrave të jetë i saktë.	Ndërmarrja kishte bërë korrigjimin e të hyrave dhe gjithashtu nuk janë hasur raste të tilla gjatë auditimit në këtë vit.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të respektohen të gjitha kërkesat që dalin nga rregullorja për menaxhimin e pronave duke siguruar një cilësi në menaxhimin e tyre.	Ndërmarrja kishte përditësuar të gjitha kontratat për pronat, duke respektuar kërkesat ligjore. Po ashtu kishte bërë përditësimin e tarifave të cilat hyn në fuqi më 2024.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve duhet të rishikojë faturimet për pronat e dhëna me qira për qëllime të banimit të jenë në harmoni me kornizën ligjore.	Ndërmarrja kishte bërë zbatimin e rekomandimit dhe kishte filluar faturimin pa TVSH.	I zbatuar
5.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që sistemi informativ i kontabilitetit të gjenerojë të gjitha informacionet e nevojshme duke përfshirë ditarin kryesorë.	Ndërmarrja edhe pse kishte lidhur kontratë për sigurimin e softuerit të sistemit të kontabilitetit, nuk kishte arritur të realizojë dhe si rrjedhojë gjendja mbetet e pa ndryshuar.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Në pasqyrat financiare, ndërmarrja ka përgatitur formatin e ri të shënimeve shpjeguese dhe ka prezantuar shënime të plota dhe të qarta.	I zbatuar
7.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të merren veprime konkrete për të regjistruar të dhënat kontabël me qëllim që të gjitha vlerat e llogarive të prezantohen saktë në pasqyrave financiare.	Ndërmarrja ka zbatuar rekomandimin në tërësi, duke përpiluar pasqyrën e rrjedhës së parasë sipas SNK-ve.	I zbatuar
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që zyrtarët financiar, regjistrimin e transaksioneve që japin efekt në disa periudha kontabël, ta bëjnë bazuar në parimin aktual, duke siguruar që të hyrat e shtyra ekonomisht maturohen (realizohen) edhe në periudhat e ardhshme kontabël.	Janë marrë veprimet konkrete për të zbatuar këtë rekomandim, duke prezantuar në mënyrë të duhur të hyrat e shtyra.	I zbatuar

9.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë të sigurojë një rishikim gjithëpërfshirës të regjistrit të pasurisë dhe të ndërmarrë veprime për rivlerësimin e pasurive nga një vlerësues i licencuar.	Ndërmarrja gjatë vitit 2023 nuk kishte marrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi për shkak të mungesës së mjeteve financiare siç e kishte potencuar në planin e veprimit.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që investimet në vijim të regjistrohen në mënyrën e duhur me qëllim që prezantimi i tyre të jetë i plotë dhe i saktë në pasqyra financiare.	Ndërmarrja kishte ndërmarr veprime konkrete duke regjistruar pasuritë-investimet në vijim siç duhet.	I zbatuar
11.	Pasuritë afatgjata	Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr veprime të menjëhershme në sigurimin e informatave lidhur me tepicën e rivlerësimit si dhe sigurojë se pasqyrat financiare vjetore të përgatiten duke u bazuar në të dhënat e konfirmuara kontabël dhe me dëshmitë e duhura.	Ndërmarrja nuk kishte bërë veprime konkrete për adresimin e këtij rekomandimi. Lidhur me këtë edhe në planin e veprimit kishte specifikuar se nuk mund të adresojnë me mjetet vetanake. Prandaj, gjendja mbetet e pa ndryshuar në raport me vitin paraprak..	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se të gjitha informacionet e prezantuara në pasqyra financiare të sigurohen përmes sistemit të kontabilitetit të ndërmarrjes.	Ndërmarrja ka adresuar këtë rekomandim duke bërë regjistrimin e projektit në sistemin e kontabilitetit.	I zbatuar
13.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që kontrollet financiare të jenë më efektive dhe azhurnimi i të dhënave të bëhet me kohë në mënyrë që shpenzimet dhe regjistrimet kontabël të reflektojnë prezantimin e drejtë të gjendjes në pasqyra financiare kur ato ndodhin realisht.	Ndërmarrja kishte ndërmarr veprime duke i siguruar faturat komunale me kohë dhe duke i regjistruar ato në periudhat përkatëse.	I zbatuar

14.	Shpenzimet operative	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që në rastin e angazhimi të Zyrës Kombëtare të Auditimit për shërbime të auditimit të PFV, të mos bëhen shpenzimet të pa nevojshme për auditim.	Ndërmarrja gjatë kësaj periudhe nuk kishte lidhur marrëdhënie kontraktuale për angazhimin e auditimit të PFV të vitit 2023.	I zbatuar
15.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se të gjitha obligimet e prapambetura të kontributeve pensionale dhe tatimet të buxhetohen dhe të paguhen sa më parë.	Ndërmarrja kishte bërë pagesat për kontributet pensionale dhe tatimet në paga, kështu që ka zbatuar në tërësi rekomandimin.	I zbatuar
16.	Shpenzimet e pagave	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për përditësimin e kontratave në harmoni me rregulloren e brendshme për paga dhe kompensime/ kategorizimin e pagave që aktualisht është në fuqi.	Ndërmarrja ka zbatuar këtë rekomandim duke bërë përditësimin e gjitha kontratave.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Valmira Jonuzi, Udhëheqëse e ekipit



Alban Shatri, Anëtar i ekipit



Arbresha Grainca, Anëtare e ekipit





# Shtojca I: Letër konfirmimi



**INFRAKOS SH.A.**  
**INFRAKOS D.D.**  
**INFRAKOS J.S.C.**

Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

Emituar Received Primiteno	19.04.2024	
Nr. punësi Work. unit Red. jed	Nr. No. Br.	Shtojca Supplement Prilog
11	605	-



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË PRANIMIT/DORËZUAR: DATE RECEIVED/SUBMITTED:			
15-04-2024			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
05	47	467	1

**NDËRMARRJA PUBLIKE**  
**- INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - INFRAKOS SH.A -**

19/04/2024

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar/a,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Hekurudhave të Kosovës Infracos sh. a.**, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.




**Znj. Edona Nahi**

Kryesuese e Bordit të Drejtoreve  
N.P. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës –  
INFRAKOS SH.A

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- <sup>2</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet



Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës  
**INFRAKOS SH.A**

**PASQYRAT FINANCIARE 2023**

Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2023

**Fushë Kosovë**

**Mars, 2024**

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>FAQE</b>
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	6
INFORMATA TE PERGJITHESHME	7
PERMBLEDHJE E POLITIKAVE DOMETHENSE TE KONTABILITETIT	8
SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT	18

INFRAKOS SHA  
PASQYRAT FINANCIAR PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31DHJETOR 2023  
"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36  
Paqyra e pozitës financiare  
Më 31.12.2023

PASURITË	Shënimi	2023	Rishikuar 2022	Rishikuar 2021
		€	€	
Pasuritë afatshkurtra				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	582,762	1,347,633	436,874
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	1,757,266	2,607,733	2,445,665
Stoqet	6	817,323	864,921	707,321
Pasuritë e tjera afatshkurtra	7	51,631	150,224	11,800
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>3,208,982</b>	<b>4,970,511</b>	<b>3,601,660</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>				
Prona, pajisjet dhe impiantet		15,170,811	16,055,798	17,048,006
Investimi në vijim		85,030,210	60,199,844	36,285,824
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>	8	<b>100,201,021</b>	<b>76,255,642</b>	<b>53,333,830</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>103,410,003</b>	<b>81,226,153</b>	<b>56,935,490</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>				
<b>DETYRIMET</b>				
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>				
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	12	47,456	655,854	672,499
Grantet e shtyera	13	40,080,848	32,181,722	26,118,479
Tatimet dhe kontrib.pens.te pagushme	14	1,270,315	1,940,308	2,084,572
Detyrime te tjera afatshkurte			-	
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>41,398,619</b>	<b>34,777,884</b>	<b>28,875,550</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>				
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	15	50,555,832	34,309,396	15,639,264
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>50,555,832</b>	<b>34,309,396</b>	<b>15,639,264</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>91,954,452</b>	<b>69,087,280</b>	<b>44,514,814</b>
<b>EKUITETI</b>				
Kapitali i aksionar	9	25,000	25,000	25,000
Fitimet e mbajtura	10	(3,795,464)	(3,112,143)	(2,830,339)
Rezervat Rivlersimit	11	15,226,015	15,226,015	15,226,015
Fitimi I vitit		-	-	
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>11,455,552</b>	<b>12,138,872</b>	<b>12,420,676</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>103,410,003</b>	<b>81,226,153</b>	<b>56,935,490</b>

z. Naser Krasniqi

Kryeshf Ekzekutiv



znj.Syleme Ahmeti-Bllaca

Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36  
Paqyra e të ardhurave gjithëpërshirëse për vitin që përfundon  
Më 31.12.2023

Shënimi	Rishikuar	
	2023	2022
	€	€
Të hyrat	2,014,569	1,902,451
Të hyrat tjera afariste	171,653	127,715
Të hyrat nga grantet	984,927	907,425
<b>Të hyrat operative</b>	<b>3,171,149</b>	<b>2,937,591</b>
Të ardhurat tjera		
Shpenzimet e pagave	17 (1,710,138)	(1,803,252)
Shpenzimet administrative & tjera	18 (386,404)	(300,855)
Shpenzimet e zhvlersimit	19 (1,060,796)	(1,057,416)
Shpenzimet e provizionimit	18.1 (549,230)	
<b>Shpenzimet operative</b>	<b>(3,706,568)</b>	<b>(3,161,524)</b>
Shpenzimet financiare	20 (149,380)	(57,871)
Të ardhurat financiare		
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>	<b>(684,800)</b>	<b>(281,804)</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
<b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>	<b>(684,800)</b>	<b>(281,804)</b>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërshirëse:</b>		
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërshirëse të vitit</b>		
<b>Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërshirëse të Vitit</b>		

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Aderesa:Sheshi I Lirisë nr.36

Paqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon

Më 31.12.2023

Shënim	Rishikuar	
	2023	2022
	€	
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	(684,800)	(281,804)
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>		
Zhvlërësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	1,060,796	1,057,416
Shpenzimet financiare	149,380	57,871
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
	525,376	833,483
<b>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</b>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	949,060	(300,492)
(Rritja) / zvogëlimi në stoke	47,598	(157,600)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	-	-
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(608,398)	(16,645)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	(669,993)	(144,264)
Rritja / (zvogëlimi) në grante	7,899,126	6,063,243
	8,142,769	6,277,726
<b>Tatimi në fitim i paguar</b>	(57,458)	-
<b>Interesi i paguar</b>	(41,407)	(57,871)
	8,043,904	6,219,855
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>		
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Pagesat për blerjet e pronës, dhe asetëve tjera	(224,845)	(65,209)
Investime ne projekte kapitale	(24,830,366)	(23,914,020)
<b>Neto rrjedha nga aktivitetet investuese</b>	(25,055,211)	(23,979,229)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Terheqjet		
Ndryshimi ne huazime	16,246,436	18,670,132
<b>Neto rrjedha nga aktivitetet financiare</b>	16,246,436	18,670,132
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>	(764,871)	910,759
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	1,347,633	436,874
	582,762	1,347,633
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>		

INFRAKOS SHA  
PASQYRAT FINANCIAR PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31DHJETOR 2023

"INFRAKOS SHA" Nr. Unik: 811415620 Adresa:Sheshi I Lirisë nr.36

Paqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon

Më 31.12.2023

	Rishikuar			Gjithsej
	Kapitali I pronarit	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	
	€	€	€	
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	25,000	(2,830,339)	15,226,015	12,420,676
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(281,804)		-
Terheqje Kapitalit/deponim				(281,804)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	25,000	(3,112,143)	15,226,015	12,138,872
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(684,800)		(684,800)
Terheqje Kapitalit/deponim	-			-
Korrigjim I fitimit te mbajtur		1479		1,479
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	25,000	(3,795,464)	15,226,015	11,455,551



**INFRAKOS SHA**  
**PASQYRAT FINANCIAR PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31DHJETOR 2023**  
**1. INFORMATA TE PERGJITHESHME**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutes së Republikës së Kosovës, Neni 33 paragrafi 1, të Ligjit mbi Hekurudhat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-076, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr.01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26 Shkurt 2010 mori Vendim mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës SH.A. Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087, për "Kompanitë Publike"; Ligjit Nr.02/L-123, për "Kompanitë Tregtare" dhe bazuar në vendimin e Qeverisë nr.05/110 të datës 26.02.2010 për ndarjen e Hekurudhat e Kosovës SH.A. , themelon:

Shoqërinë Aksionare "Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A." me NUI 811415620, e cila është përgjegjëse për asetet, pronën, dhe gëzon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin si pasojë e këtij transformimi.

Shkurtesa e emërimit është "INFRAKOS" SH.A.

Selia e kompanisë gjendet në Komunën e Fushë Kosovës "Sheshi i Lirisë" pn. Kompania mund të zhvilloj aktivitetin e saj në territorin e Kosovës dhe jashtë saj.

Kompania, sipas Statutit të saj dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës mund të hapë Qendra zyra përfaqësuese, filiale, degë dhe kompani të tjera si në Republikën e Kosovës ashtu edhe jashtë vendit. Sthurja financiare e Hekurudhave të Kosovës SH.A. është bërë nga grupi punues i përbërë prej tetë anëtarëve bazuar në vendimin e dates 18.05.2010 Nr.571. në bazë të cilit vendim është bërë ndarja e mjeteve financiare, ndarja e borxheve dhe ndarja e obligimeve financiare në dy kompani të reja "INFRAKOS" SH.A. dhe "TRAINKOS"

#### **1.1 Aktivitetet biznesore të kompanisë**

